



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:248159

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05364168

C.nr.1833/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Rr. H., nga Podujeva, përfaqësuar me autorizim nga Xh. K., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës “K. ing. 1969” sh.p.k, me seli në Prishtinë, me drejtor Sh. Sh., përfaqësuar me autorizim nga F. Sh., avokat në Prishtinë, me objekt të kontestit shpërblimin e dëmit material dhe jo material, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik me datë 18.01.2024, në të cilën kanë prezantuar palët ndërgjyqëse dhe të autorizuarit e tyre, më datë 02.02.2024 dha dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e themeltë kërkesëpadia e paditësit Rr. H., nga Podujeva, dhe DETYROHET e paditura “K. ing. 1969” sh.p.k, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jo material të pësuar për shkak të lëndimit në punë me datë 14.12.2012, për 70% të përgjegjësisë t’ia paguaj shumat si vijon:

A. Në emër të dëmit jo material:

- a. Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....4,200.00€
- b. Për frikën e pësuar, shumën prej.....3,500.00€
- c. Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej.....6,720.00€
- d. Për shëmtim trupor, shumën prej.....1,750.00€

B. Në emër të dëmit material:

- a. Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....588.00€
- b. Për ndihmë të nevojshme për ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës dhe veshmbathjes, shumën prej.....588.00€
- c. në emër të kompensimit të dëmit për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese – fitimit të humbur dhe atë për periudhën nga data 01.03.2017, e deri në datën 31.10.2023, shumën e mjeteve në lartësi prej 16,516.05 €, si dhe në emër të fitimit të humbur në të ardhmen t’i paguaj paditësit rentën mujore nga data 01.11.2023, e deri në plotësimin e kushteve ligjore, në shumën mujore prej 236.29 €, e cila pagesë do të bëhet më së largu deri më datën 05 të muajit vijues.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguaj kamatën në lartësi t’i paguaj me kamat vjetore prej 8%, dhe atë për pikën A) në emër të dëmit jo material duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (02.02.2024), e deri në pagesën e plotë, kurse për nën-pikat a) dhe b) të pikës A) në emër të dëmit material të dispozitivit I të këtij aktgjykimi duke filluar nga data e parashtrimit të padisë më datë 07.08.2015 e deri në pagesën e plotë, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

III. DETYROHET e paditura që shumën e gjykuar në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese – fitimit të humbur dhe atë për periudhën nga data 01.03.2017, e deri në datën 31.10.2023, për shumën e mjeteve në lartësi prej 16,516.05, t’ia paguaj paditësit në emër të kamatës për këtë periudhë shumën prej 3,913.23€, kurse për rentën e gjykuar për periudhën e ardhme, kamata do të llogaritet sipas arritjes së secilës rentë mujore të gjykuar, në lartësinë prej 8% në vit, e deri në pagesën definitive të secilës rentë mujore.

IV. REFUZOHET si e pathemeltë pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Rr. H., nga Podujeva, mbi shumat e aprovuara dhe atë: për dhembjet e përjetuara fizike shumën prej 10,800€; për frikën e pësuar shumën prej 11,500.00€; për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 8,250.00€; dhe për shëmtim trupor shumën prej 13,250.00€, për ushqim të përforcuar shumën prej 3,012.00€, Për ndihmë të nevojshme për ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës dhe veshmbathjes, shumën prej 1,812.00€, për rehabilitim fiziko terapeutik

shumën prej 1,500.00€, për blerjen e barnave për shërim shumën prej 500.00€, për zvogëlimin e aftësisë punuese – fitimit të humbur dhe atë për periudhën nga data 01.03.2017, e deri në datën 31.10.2023, shumën e mjeteve në lartësi prej 7,078.22 €, si dhe në emër të fitimit të humbur në të ardhmen nga data 01.11.2023, në shumën mujore prej 101.28€, dhe për kumatën për rentën në shumën prej 2,077.11€.

V. DETYROHET i padituri që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shumën në lartësi prej 2,460.40€, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij me datë 07.08.2015, ka parashtruar padi, kundër të paditurës, për shpërblimin e dëmit material dhe jo material, së fundi të precizuar me parashtrësën e datës 23.11.2023, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të dëmit material dhe jo material për lëndimet e pësuar në aksidentin e datës 14.12.2012, në vendin e punës t’ia paguaj dhe atë në emër të dhimbjeve fizike të të gjitha intensiteteve shumën prej 15,000.00€, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 15,000.00€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 29.59%, shumën prej 15,000.00€, në emër të shëmtimit të rëndë shumën prej 15,000.00€, në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese – fitimit të humbur në formë rente të kapitalizuar nga data 01.03.2017 e deri në pensionim e tij shumën prej 109,345.71€, në emër të ndihmës së personit të tretë për periudhën prej 4 muaj nga 30 në ditëm apo 3,600.00€, në emër të ushqimit të përforcuar për 120 ditë nga 20€ për ditë, apo 2,400.00€, në emër të rehabilitimit fiziko terapeutik për 50 ditë nga 30.00€, në ditë apo 1,500.00€, në emër të shpenzimeve mjekësore shumën prej 500.00€, të gjitha këto me kumatë prej 8 %, nga dita e shkaktimit të lëndimit e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj ka ushtruar përgjigje në padi duke e kontestuar kërkesëpadinë me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar. Ka shtuar se nga provat e administruara në këtë çështje është vërtetuar se përgjegjës për shkaktimin e aksidentit ka qenë

vetë paditësi. Kjo është konstatuar nga eksperti B. B., dhe dëshmitarët e dëgjuar. Më tej ka deklaruar se paditësi ka qenë i pajisur me mjet për sigurinë në punë. Nga kjo rezulton se nuk është bërë e besueshme kërkesëpadia e paditësit kundër të paditurës. Nga këto i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: vërtetimi i policisë së Kosovës numër ... i datës 12.03.2015, dokumentacioni mjekësor për paditësin, qarkullimi bankar i paditësit në NLB bankë, ekspertiza mbi vlerësimin e rrethanave të aksidentit në punë e datës 24.10.2022, ekspertiza mjekësore e datës 15.12.2022, nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, ekspertiza mjekësore nga lëmia e punës e datës 22.05.2023, ekspertiza financiare e datës 20.10.2023, dhe plotësimi i saj i datës 20.11.2023.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa kontestuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar tek e paditura, i caktuar në detyrat e punës si punëtor. Po ashtu gjykata gjeti se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi përderisa ishte duke punuar tek e paditura, si pasojë e aksidentit në punë ka pësuar lëndime trupore.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet, nëse paditësi ka të drejtë në kompensim për shkak të lëndimeve të marra tek e paditura, ashtu që në njërin anë pala paditëse pretendon se i takon një kompensim i tillë, ndërsa e paditura pretendon se nuk i takon kompensimi, ngase e paditura nuk mund të mbahet përgjegjëse, për këtë në thelb palët kishin pikëpamje diametralisht të kundërta.

Me qëllim të vërtetimit të mënyrës se si janë gjendur palët ndërgjyqëse në këtë aksident, pra vërtetimit të lëshimeve të palëve, gjykata ka caktuar ekspertimin përmes ekspertit për mbrojtje dhe siguri në punë, me ekspert B. B. Përmes ekspertizës së punuar të datës 24.10.2022, gjykata gjeti se e paditura ka përgjegjësi primare për shkaktimin e aksidentit pasi që lëndimi ka ndodhur gjatë orarit të punës, duke i hequr shtyllat metalike dhe dërrasat nga tavani, lëndimi ka ndodhur në mungesë të rrethojës mbrojtëse – siguroese të pllakës, paditësi nuk ka qenë i aftësuar për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, nuk është formuar Komisioni intern për vlerësimin e shkaqeve të aksidentit, paditësit nuk i janë dhënë udhëzimet për punë të sigurt në vendin e punës, punëdhënësi ka shkelur Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ndërsa paditësi ka përgjegjësi sekondare për shkaktimin e aksidentit pasi që nuk e ka vlerësuar sa duhet rrezikshmërinë me rastin e heqjes së dërrasave e sidomos të ngricave dhe nuk ka pasur kujdes adekuat gjatë përdorimit të levës për heqjen e dërrasave.

Ekspertiza për mbrojtje dhe siguri në punë e nxjerrë në këtë çështje kontestimore, ka ofruar të dhëna lidhur me përgjegjësinë e ndarë të palëve ndërgjyqëse në përpjesëtim me veprimet që ka qenë dashur t'i ndërmarrin. Gjkata e ka pranuar ekspertizën në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar.

Gjkata përmes kësaj ekspertize ka konstatuar se në rastin konkret kemi të bëjmë më përgjegjësi të ndarë. E për këtë arsye gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë ta aprovoj sa i përket bazës për 70% të përgjegjësisë por jo edhe lartësinë e kërkesës për të gjitha kategoritë e dëmit. Sa i përket përgjegjësisë së ndarë gjykata ka aplikuar dispozitën se nenit 159 par. 2 e Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore - (LMD), nga rrjedh se në çoftë se ekziston faji dypalësh, secili zotërues përgjigjet për dëmin total që kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajësisë së tyre.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident në punë, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertimit me ekspertë nga lëmia e ortopedisë dhe nga lëmia e psikiatrisë, të cilën e kanë punuar Dr. V. B.-ortoped dhe Dr. B. O.-psikiatre.

Eksperti ortoped, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit të ndodhur ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si lëndime të rënda trupore.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike aprovoi kërkesën në shumën si në dispozitiv dhe të njëjtën e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, gjithashtu lëndime të ndryshme. Eksperti ka gjetur se paditësi ka pësuar fraktura multigragmentre e subtrchanterke femurit të majtë, pylon fractura kërcirit të djathtë dhe fraktura unazës së shpinës L1. Po ashtu përmes ekspertizës është gjetur se paditësi ka pësuar dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë rreth një orë, duke marrë parasysh vendndodhjen e aksidentit e deri në realizimin e ekzaminimit klinik, radiologjik dhe marrjen e ndihmës së parë. Pastaj ka pësuar dhimbje fizike me intensitet të rëndë për 4 ditë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë së ordinuar për shkak të dhimbjeve në regjionin e shpinës, kofshë së majtë dhe kërcirit të djathtë duke përfshirë edhe dhimbjet pas katër intervenimeve kirurgjike. Me intensitet të mesëm 30 ditë, dhe dhimbjet me intensitet të ulët ende vazhdojnë.

Eksperti ortoped ka gjetur se paditësi ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 29.59%, për shkak të zvogëlimit të lëvizshmërisë të pjesës lumbale të boshtit kurrizot të shkallës së ulur pas frakturës së unazës së shpinës L2, për shkak të ngjitjes jo të rregullt të femurit të majt në antekurvatum, ngjitjes jo të rregullt të kërcirit të djathtë me retrokurvatum, për shkak të astrozes së nyjës dhe pasojat e trombozës venoze. Prandaj për këtë kategori të dëmit është caktuar shuma e kompensimit në lartësi si në dispozitiv.

Në emër të shëmtimit gjykata ka caktuar shumën e kompensimit si në dispozitiv ngase është vërtetuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pasur shëmtim në shkallë të mesme, për shkak të çalimit, ecjes së shtrembët në këmbën e djathtë si dhe për shkak të vrazave të mbetura pas intervenimeve kirurgjikale dhe atë në regjionin e shpinës me gjatësi prej 22 cm, në regjionin e jashtëm të kofshës së majtë me gjatësi 34 cm, regjionin e kërcit të djathtë me gjatësi nga ana e brendshme 15 cm dhe nga na e përparme 5 vrazat me gjatësi 1x0.5 cm, e që vërehet gjatë ecjes, stinëve të ngrohta dhe verimeve e bazuar edhe në moshën e re. Prandaj

shkalla e vrajave e justifikon vlerën e kompensimit të caktuar lidhur me këtë shkallë të shëmtimit.

Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka paraqitur se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje 4 muaj, duke përfshirë ndihmën që konsiston në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës, veshmbathjes etj., i ndihmuar nga familjarët. Kurse ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 120 ditë, i pajisur me proteina, minerale, vitamina etj.

Për frikën është caktuar shuma e kompensimit në lartësi si në dispozitiv, pasi që nga eksperti psikiatër është konstatuar se paditësi ka pësuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekondat si reagim i fuqishëm afektiv ndaj rrezikut të çastit; Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për rreth tri orë; Frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur për 4 muaj; Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka dhe sot e kësaj dite.

Gjykata ekspertizën mjekësore: të ekspertit të ortopedisë dhe të psikiatrisë, e ka pranuar në tërësi si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Ligji nr. 04/L-077 (LMD) e rregullon çështjen e kompensimit të dëmit. Neni 136 i LMD-së, thotë: Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga fajin. Kurse neni 154 i LMD-së përcakton se: Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit. Ndërsa neni 5 par. 1 i Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, përcakton se: Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. Kurse neni 6 par. 1 rregullon se: Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave,

trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.

Gjykata përmes provave të administruara të cilat dërguan në gjendjen faktike të vërtetuar, gjeti se e paditura mbahet përgjegjëse për shkaktimin e dëmit në këtë rast kontestues, kjo ngase lëndimi i paditësit ka ardhur si pasojë që i njëjti ka qenë duke punuar tek e paditura dhe për llogari të saj, kurse e paditura ka dështuar në ndërmarrjen e veprimeve që mos të vije deri tek fatkeqësia. E njëjta ka pasur për obligim që të organizoj apo ndërmarr masat e nevojshme për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, përfshirë këtu parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimin, organizimin përkatës dhe masave të duhura për të siguruar, mirëmbajtur makineritë, instrumentet, pajisjet etj.

Gjykata gjeti se e paditura nuk ka respektuar obligimet ligjore të parapara me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, të cilat u elaboruan, ndërsa gjykatës nuk i ofroi prova që do të dëshmonin se e paditura nuk mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit, e që do të kishin si pasojë lirim nga përgjegjësia të të paditurës. Kurse në anën tjetër u gjet se e paditura ka dështuar në ndërmarrjen e masave preventive sipas nenit 18 të Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Gjykata vë në dukje se tek rastet e dëmit jashtë kontraktual duhet të plotësohen disa kushte siç janë: a) ekzistenca e dëmit, b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit, c) ekzistenca e fajit (me dashje apo nga pakujdesia), dhe d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. Rrjedhimisht, tek rasti kontestues është përmbushur elementi i lidhjes kauzale apo shkakore, që tërheq pas vetes edhe fajin më pastaj përgjegjësinë.

Gjykata vlerëson se tek ky rast përmbushen elementet e lidhjes shkakore që paraqet raportin e ndërsjellët ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij. Pra lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, që ekziston midis veprimit

ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Çdo ngjarje që është kusht për dëmin, d.m.th., pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron të paditurin të shpërblej dëmin. Së këndejmi lidhja kauzale duhet të jetë e atillë që duhet të dëshmojë për ngjarjen e cila sigurt është shkaktuar si pasojë e veprimit apo mosveprimit të personit. Përfundimisht, në këtë proces kontestimor, pala e paditur nuk arriti të argumentojë se ka ndërmarrë masat preventive, duke përfshirë informimin e punëtorit-paditësit për rreziqet në vendin e punës, mbajtja trajnimeve etj.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material). Neni 137 i LMD-së thotë: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se: Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Prandaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuar për paditësin, moshën e tij, vlerësimin në ekspertizave mjekësore dhënë mbrojtje dhe sigurisë në punë, miratoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit të bazuar në vlerën e shpërblimit të dëmit si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se shumatat e kompensimit të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj paditësit satisfaksion që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po që se të njëjtat nuk do t'i kishte humbur, gjithë kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e

nevojshme të shërimit, nevojat e shtuara për mjekim, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, respektivisht pasojat e lëndimeve më afër të përshkruara si në mendimet e ekspertëve ortoped dhe psikiatër. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu kriteret e vëna nga praktika gjyqësore.

Për të përcaktuar aftësinë e përhershme punuese të paditësit pas aksidentit në vendin e punës, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertizës nga lëmia e punës, të cilën e ka punuar Dr. A. H. me datë 22.05.2023. Eksperti në bazë të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka vlerësuar aftësinë punuese të paditëses për punët fizike në ndërtimtari me ç'rast ka konstatuar se nga dita e aksidentit dt.14.12.2012 e plot tri vite deri më 14.12.2015, paditësi ka pasur paaftësi të përkohshme dhe të plotë në shkallë prej 100%. Tutje, eksperti ka vlerësuar se nga data 14.12.2015 e deri me 14.12.2016, paditësi ka pasur paaftësi të përkohshme të punës në shkallë prej 100%. Nga data 14.05.2016, e deri në ditën e ekzaminimit më datë 17.05.2023 dhe në ardhmen aftësia e përhershme për punët në ndërtimtari është zvogëluar në shkallë prej 80% dhe është definitive, nuk priten përmirësime.

Gjykata ekspertizën e mjekësisë së punës dhe plotësimin e saj, e ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale, e argumentuar, dhe e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Si rezultat i vërtetimit të gjendjes faktike për sa i përket zvogëlimit të aktivitetit punues, përmes ekspertizës mjekësore, sipas propozimit të autorizuarit të paditëses, gjykata për të vërtetuar lartësinë e kompensimit që i referohet fitimit të humbur-rentës, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare të cilën e ka punuar A. B. Eksperti është bazuar në ekspertizën e mjekësisë së punës të dt.22.05.2023 edhe atë duke marr për bazë shkallën e invaliditetit edhe atë në vitin e parë pas aksidentit 100% për çdo lloj pune për tri vitet e para, vitit të 4-të pas aksidentit 100% për punë në ndërtimtari dhe pas vitit 4 pas aksidentit 80%, për punë të përhershme në ndërtimtari. Në këtë mënyrë eksperti ka llogaritur rentën mujore

në proporcion me reduktimin e aftësisë së saj punuese të paditësit për kryerjen e punëve të ndërtimtarisë nga baza e pagës së punëtorëve të pakualifikuar aq sa mund të supozojmë se do të ishte kontributi i tij në familje i shprehur financiarisht po të mos aksidentohej. Rrjedhimisht eksperti ka konstatuar se për periudhën e kaluar prej datës së aksidentit 14.12.2012 deri me 31.10.2023 shuma e gjithmbarshme e rentës arrin në vlerë prej 23,594.27€, së bashku me kamatën prej 5,990.34€. Kurse, për periudhën e ardhshme prej datës 01.11.2023 e në të ardhmen deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, shumën prej 337.57€ në muaj. Po ashtu, eksperti ka kalkuluar rentën e kapitalizuar, e cila arrin në shumë prej 79,761.00€. Pra, vlera e kompensimit për këtë pjesë, paraqet harmonizim mes profesionit të paditësit, me shkallën e lëndimit shprehur në përqindje.

Gjykata ekspertizën aktuaristikës dhe plotësimin e saj e ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna të arsyetuara lidhur me mënyrën e llogaritjes së rentës së arritur dhe asaj që duhet të rrjedhë muaj për muaj.

Lidhur me mënyrën e vendosjes që ka të bëjë me rentën, gjykata ka aplikuar dispozitën e nenit 172 par. 1 të LMD-së ku përcaktohet se: “Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar”. Gjykata vlerëson se për këtë kategori të dëmit rivendosja e gjendjes së mëparshme është e pa mundur, ngase paditësja ka humbur aftësinë punuese, në shkallën 40% për të ardhmen, prandaj shpërblimi i dëmit duhet të bëhet në formë të rentës në të holla. Kurse për pagesën e rentës mujore gjykata aplikoi nenin 172 par. 1, sipas të cilit: “Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër”, e caktuar në shumë si në dispozitiv, për çdo muaj e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në përpjesëtim me shkallën e zvogëlimit të aftësisë punuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 18.01.2023, ka dëgjuar dëshmitarët e propozuar dhe e paditura dhe ka dëgjuar paditësin në cilësinë e palët dhe nga të njëjtit vërtetoi rrethana që tashmë kanë qenë të vërtetuara me provat materiale, andaj edhe nuk është lëshuar në vlerësimin e mëtejshëm të tyre.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin material dhe jo material gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit duke përfshirë: për dhembjet e përjetuara fizike shumën prej 10,800€; për frikën e pësuar shumën prej 11,500.00€; për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 8,250.00€; dhe për shëmtim trupor shumën prej 13,250.00€, për ushqim të përforcuar shumën prej 3,012.00€, Për ndihmë të nevojshme për ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës dhe veshmbathjes, shumën prej 1,812.00€, për rehabilitim fiziko terapeutik shumën prej 1,500.00€, për blerjen e barnave për shërim shumën prej 500.00€, për zvogëlimin e aftësisë punuese – fitimit të humbur dhe atë për periudhën nga data 01.03.2017, e deri në datën 31.10.2023, shumën e mjeteve në lartësi prej 7,078.22 €, si dhe në emër të fitimit të humbur në të ardhmen nga data 01.11.2023, në shumën mujore prej 101.28€, dhe për kamatën për rentën në shumën prej 2,077.11€. Për këtë pjesë, është vlerësuar se kompensim përtej shumave të gjykuara, nuk do të ishin në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Duke qenë se pas administrimit të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se paditësit i takon edhe kamatëvonesa, gjykata lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit: Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi të kryesor, edhe kamatën. Për sa i përket dëmit material llogaritja e saj është caktuar të jetë nga dita e parashtrimit të padisë, ngase në shkresat e lëndës nuk është gjetur dëshmi se paditësi pranë të paditurës të ketë parashtruar kërkesë për kompensim, kurse ajo të mos i jetë përgjigjur. Ndërsa për dëmin jo material, rrjedha e kamatës është caktuar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit (në këtë mënyrë edhe Mendimi juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i dt.02.12.2020).

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së dhe atë si në vijim: për padi shumën prej 208.00€, për taksën gjyqësore për padi shumën prej 30.00€, shpenzimet për ekspertiza dhe atë: psikiatrike 100.00€, ortopedike 100.00€, dhe nga lëmia mjekësisë së punës 200.00€, aktuaristikës 200.00€, për 6 seanca nga 270.40€, për secilën veç e veç apo në shumë të përgjithshme 2,460.40€.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.1833/2015, datë 02.02.2024

Gjyqtari

Përparim Zeka

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.